

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-14601
Më 6.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për KF "Liria", kryetari i Komunës më 6 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për KF "Liria", me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për ushtrimin e aktiviteteve sportive, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete financiare në lartësi prej 16.100 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KF "Liria", si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës


Nr. 01/011-12923

Më: 4.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit për themelimin e Këshillit Profesional dhe Këshillit Teknik për shënimin e gjashtë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, kryetari i Komunës më 4 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Profesional për organizimin dhe shënimin e gjashtë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
2. Për anëtarë të Këshillit Profesional, emërohen:
 - 2.1. Kujtim Gashi, kryesues i Kuvendit të Komunës - kryetar i Komisionit, dhe
 - 2.2. Shefat e grupeve parlamentare e të gjitha subjekteve politike, që janë pjesë përbërëse e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.
3. Detyrat e Këshilli Organizativ do të jenë: Të hartojë strategjinë dhe konceptin ideor rreth shënimit të përvjetorit të Pavarësisë, konstruktin financiar të këtij manifestimi dhe të marrë veprime tjera sipas nevojës.
4. Themelohet Këshilli Teknik për shënimin e gjashtë vjetorit të Pavarësisë në këtë përbërje:
 - 4.1. Urim Ukimeri –kryetari i këtij Këshilli,
 - 4.2. Zeqir Xhaferi,
 - 4.3. Hamdi Bilurdagu,
 - 4.4. Bashkim Lubovci dhe
 - 4.5. Visar Islamaj.
5. Detyrat e komisionit Teknik do të jenë: t'i zbatojnë urdhërat dhe detyrat e dhëna nga ana e Këshillit Profesional, lidhur me organizimin dhe shënimin e gjashtë vjetorit të Pavarësisë.
6. Lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me shënimin e përvjetorit të Pavarësisë.
7. Mjetet lejohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe drejtorive tjera komunale.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të emëruarit.



Kryetari i Komunës
D. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-14710

Më 7.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Turqi dhe pagesës së shpenzimeve të udhëtimit (biletës kthyesë të aeroplanit dhe autobusit) për Xhengiz Gjurgjealo, zyrtar komunal për komunitete, kryetari i Komunës, më 7 shkurt 2014, miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Turqi të Xhengiz Gjurgjealo, zyrtar komunal për komunitete, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën me temën kombi turk. Konferenca organizohet nga Organizata e intelektualëve të qytetit Koxheali dhe e njëjta do të mbahet me datën 28 shkurt 2014 në qytetin Koxheali të Turqisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e shpenzimeve të udhëtimit (bileta kthyesë e aeroplanit në relacionin Prishtinë-Stamboll dhe anasjelltas dhe bileta kthyesë e autobusit Stamboll-Koxheali dhe anasjelltas), për të lartcekurin.

Mjetet për pagesë lejohen pas prezantimit të biletave përkatëse.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-16021
Më 10.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Fatmir Pirecin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 10 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Fatmir Pirecit, zyrtar komunal për çështje sociale, për në Tiranë të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në tryezën e II –të ndërkombëtare me temën: Strehimi i qëndrueshëm i bashkësisë rome. Ttryeza do të mbahen nga data 25 shkurt deri me 28 shkurt 2014, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.




Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-19196
Më 19.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës më 19 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

- I. Lejohen mjetet për pagesë të mbushjeve të telefonisë mobile për vitin 2014, (1 janar 2014-31 dhjetor 2014), për përfituesit e këtyre mbushjeve, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare.
- II. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është lista e përfituesve të mbushjeve të telefonisë mobile të Komunës së Prizrenit, të miratuar nga kryetari i Komunës.
- III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Sektori i Furnizimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- V. Me këtë Vendim të njoftohen: Sektori i Furnizimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.
- VI. Ky Vendim hyn në në ditën e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-19957
Më 20.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 20.2.2014, për lejimin e mbajtjes së manifestimit tradicional kushtuar 7 Marsit– Ditës së Mësuesit, kryetari i Komunës më 20 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e mbajtjes së manifestimit tradicional kushtuar 7 Marsit– Ditës së Mësuesit dhe për lejimin e mjeteve për organizimin dhe shënimin e këtij manifestimit, andaj për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 4000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-21164
Më 25.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për përkrahje financiare të Shoqatës për mbrojtjen e zogjve dhe ambientit „Finch“, kryetari i Komunës më 25 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për përkrahje financiare të Shoqatës për mbrojtjen e zogjve dhe ambientit „Finch“, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve lidhur me shënimin dhe organizmin e manifestimit “Dita botërore e kafshëve të egra në Kosovë”, andaj për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 495.00 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Shoqata “Finch”, si dhe Arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Maja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22897
Më 28.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, të datës 28.2.2014, për lejin e mjeteve financiare për organizimin dhe shënimin e “8 Marsit-Ditës së Grave”, kryetari i Komunës më 28 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 28.2.2014, për lejin e mjeteve financiare për organizimin dhe shënimin e “8 Marsit-Ditës së Grave”, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare.

Mjetet do të lejohen pas parashtrimit të faturave dhe dokumentacionit përkatës (foto, videoincizime, etj),

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22795
Më 27.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 25.2.2014, bazuar në kërkesën e OJQ “Kljuç”, për përkrahje financiare për organizimin e një seminari –tryeze, me rastin e “8 Marsit-Ditës së Grave”, kryetari i Komunës më 27 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 25.2.2014, i bazuar në kërkesën e OJQ “Kljuç”, për përkrahje financiare për organizimin e një seminari-tryeze me temën: “Forcimi ekonomik i gruas” që do të mbahet me rastin e “8 Marsit-Ditës së Grave”, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 800 €.

Mjetet do të lejohen pas parashtrimit të faturave dhe dokumentacionit përkatës (foto, videoincizime, etj),

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ “Kljuç”, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22798
Më 27.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 25.2.2014, bazuar në kërkesën e OJQ “Zybeyde Hanim”, për përkrahje financiare për organizimin e një debati dhe shtrimi i një dreke për gratë e komuniteti turk me rastin e “8 Marsit-Ditës së Grave”, kryetari i Komunës më 27 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 25.2.2014, i bazuar në kërkesën e OJQ “Zybeyde Hanim”, për përkrahje financiare për organizimin e një debati me temën Roli i gruas në familje dhe shtrimit të një dreke për gratë e komunitetit turk me rastin e “8 Marsit-Ditës së Grave”, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 800 €.

Mjetet do të lejohen pas parashtrimit të faturave dhe dokumentacionit përkatës (foto, videoincizime, etj),

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Zyra për Komunitete dhe Kthim, OJQ “Zybeyde Hanim”, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22800
Më 27.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 25.2.2014, bazuar në kërkesën e OJQ “Rumeli Kosova Turk Tiyatro Sanatçilari”, për përkrahje financiare, kryetari i Komunës më 27 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 25.2.2014, i bazuar në kërkesën e OJQ “Rumeli Kosova Turk Tiyatro Sanatçilari”, për përkrahje financiare për shtrimin e një darke për artistët turke nga Teatri shtetëror i qytetit të Konjës, të cilët do të vizitojnë vendin tonë nga data 10 deri me 14 mars, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 400 €.

Mjetet do të lejohen pas parashtrimit të faturave dhe dokumentacionit përkatës (foto, videoincizime, etj),

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Zyra për Komunitete dhe Kthim, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramazan Muja,

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22797
Më 27.2.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 25.2.2014, bazuar në kërkesën e OJQ "Iniciativa 6", për përkrahje financiare për shtrimin e një dreke, me rastin e "8 Marsit-Ditës së Grave", kryetari i Komunës më 27 shkurt 2014, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 25.2.2014, i bazuar në kërkesën e OJQ "Iniciativa 6" - nëngrupi i grave "Oaza", për përkrahje financiare për shtrimin e një dreke, me rastin e "8 Marsit-Ditës së Grave", kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 600 €.

Mjetet do të lejohen pas parashtrimit të faturave dhe dokumentacionit përkatës (foto, videoincizime, etj),

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ "Iniciativa 6", si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja